

Vendim nr. 119 datë 30.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 30.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ELVIN BEHAJ, përfaqësuar nga avokat Thomas Dhimolea, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-500, datë 13.02.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave të gjykimit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar (*KPC*); neni 48, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Elvin Behaj (*kërkuesi*) është konstatuar në shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe nga ana e policisë është ndëshkuar me gjobë, si dhe marrjen e licencës taksi. Duke mos qenë dakord me këtë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me padi me objekt anulimin e aktit administrativ, procesverbalit të konstatimit të shkeljes dhe vendimit nr. 376, datë 09.05.2022 të Organit Administrativ Shtetëror në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë (*DVP, Vlorë*), kthimin e licencës, shpërblimin e dëmit moral, si dhe dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 521, datë 19.07.2022, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe shfuqizimin e procesverbalit të konstatimit të shkeljes dhe të vendimit të DVP-së, Vlorë, si dhe detyrimin e palës së paditur t'i kthejë licencën kërkuesit. Ky vendim është dhënë nga gjykata me ekzekutim të përkohshëm. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, DVP-ja, Vlorë, e cila ka ushtruar edhe ankim të veçantë, për sa i takon urdhërimit për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

3. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kërkuar: *“Ndreqjen e gabimit të vendimit nr. 521, datë 19.07.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.”*. Me vendimin nr. 33, datë 08.02.2023, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndaj këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim.

4. Aktualisht të dyja çështjet, qoftë ajo e themelit, ashtu dhe çështja për ndreqjen e gabimit të vendimit, ndodhen në Gjykatën Administrative të Apelit në pritje të gjykimit, ku e para është regjistruar me nr. 31160-03088-86-2022, datë 18.10.2022, ndërsa e dyta është regjistruar me nr. 300005-02775-86-2023, datë 24.10.2023.

5. Në datën 24.11.2023, ndërsa nuk ka konsideruar t'i kërkojë gjyqtarit relator në Gjykatën Administrative të Apelit përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, referuar nenit 460, pika 3, të KPC-së, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave të gjykimit në gjykatën e apelit për të dyja çështjet si më sipër, bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, pasi ka marrë informacion nga gjyqtarja relatore në Gjykatën Administrative të Apelit, me vendimin nr. 00-2024-500, datë 13.02.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, me arsyetimin se Gjykata Administrative e Apelit gjendet në pamundësi objektive për të marrë në shqyrtim çështjet për shkak të ngarkesës së madhe që ajo gjykatë ka. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka

argumentuar edhe në drejtim të kriterit të rrezikut për kërkuesin, duke vlerësuar se situata konkrete nuk sjell asnjë rrezik për të, për sa kohë që vendimi është dhënë me ekzekutim të përkohshëm.

7. Në datën 28.03.2024 (*sipas shërbimit postar*) kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 16.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të *gjkimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk ka marrë parasysh tejkalimin e afatit ligjor të gjykimit nga Gjykata Administrative të Apelit, me argumentin se ajo gjendet në pamundësi objektive për të marrë në shqyrtim çështjen për shkak të ngarkesës së madhe që ka, në një kohë kur sipas jurisprudencës kushtetuese ngarkesa e krijuar nga reforma në drejtësi nuk konsiderohet më si justifikim. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë që ka arsyetuar se konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm nuk mund të bëhet pa u urdhëruar edhe përshpejtimi i procedurave, është i gabuar, duke i cenuar edhe të drejtën e kompensimit për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht,

për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kolegji çmos se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete.

12. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të të dyja çështjeve të tij të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilat Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-500, datë 13.02.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

13. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, është i datës 13.02.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 28.03.2024 (*sipas shërbimit postar*), pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm të të dyja çështjeve të tij të regjistruara në Gjykatën Administrative të Apelit. Edhe pse kërkuesi ka paraqitur kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë, ajo ka vlerësuar se gjendet në pamundësi objektive për të marrë në shqyrtim çështjen për shkak të ngarkesës së madhe të çështjeve në gjykatën e apelit.

15. Për sa më sipër, në referim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit *prima facie*, përfshihet në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e shqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm

16. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk ka marrë parasysh kërkesën e tij për tejkalimin e afateve ligjore të gjykimit nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, me argumentin se ajo gjendet në pamundësi objektive për të marrë në shqyrtim çështjen për shkak të ngarkesës së madhe që ka. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë, duke arsyetuar se konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm nuk mund të bëhet pa u urdhëruar edhe përshpejtimi i procedurave, ka cenuar edhe të drejtën e tij të kompensimit për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit.

17. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

18. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Kolegji vëren se neni 48 i ligjit nr. 49/2012, parashikon afatin ligjor 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”)

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se çështja e themelit është regjistruar në gjykatën e apelit me nr. 31160-03088-86-2022, datë 18.10.2022, ndërkohë që çështja për ndreqjen e gabimit të vendimit të dhënë nga shkalla e parë është regjistruar me nr. 300005-02775-86-2023, datë 24.10.2023. Në vijim, Kolegji po ashtu vëren se datën 24.11.2023 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Apelit për të dyja çështjet. Për rrjedhojë, në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën e Lartë kishte kaluar 1 vit, 1 muaj e 4 ditë nga regjistrimi i çështjes së themelit, pra ishte tejkaluar afati i arsyeshëm ligjor 1-vjeçar, i parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së me 1 muaj e 4 ditë, ndërsa në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, ky tejkalim i këtij afati ishte 5 muaj e 8 ditë. Për sa i takon çështjes me objekt korrigjimin e vendimit, nuk rezulton të ketë kaluar afatin e arsyeshëm ligjor për shqyrtimin e saj.

20. Ashtu sikurse është pranuar edhe nga Gjykata e Lartë, vonesa (lidhur me çështjen e themelit) ka ardhur si rezultat i ngarkesës së madhe dhe akumulimit të dosjeve në Gjykatën Administrative të Apelit ndër vite. Pas kërkesës drejtuar gjyqtarës relatores, kjo e fundit ka

parashtruar mendimin e saj me shkrim, duke argumentuar se kjo çështje është rishortuar disa herë për shkak të ndryshimeve të shpeshta të numrit të gjyqtarëve efektivë në gjykatë dhe se çështja konkrete i ka kaluar asaj me shortin elektronik të datës 25.10.2023. Gjithashtu, relatorja argumenton se aktualisht po shqyrton çështjet e themelit të regjistruara në atë gjykatë në vitin 2017, duke zbatuar kriterin ligjor sipas rendit kronologjik, bazuar në datën e regjistrimit në gjykatë.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuesin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës, kërkohet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë gjykimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 25, datë 11.05.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Referuar akteve të paraqitura nga kërkuesi, konkretisht nga vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, rezulton se nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë atij i është pranuar padia dhe vendimi është dhënë me ekzekutim të përkohshëm (*shih paragrafin 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Nisur nga ky fakt, Kolegji çmon se kërkuesi mund të vinte në ekzekutim të menjëhershëm këtë vendim duke mënjeluar në këtë mënyrë çdo dëm apo rrezik të mundshëm që mund t'i vinte nga akti administrativ i kundërshtuar prej tij. Në rastin konkret, bëhet fjalë për shfuqizimin e sanksionit administrativ dhe kthimin e licencës taksi të tij. Gjithashtu, Kolegji konstaton se kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument në lidhje me faktin nëse vendimi i gjykatës së shkallës së parë është vënë në ekzekutim ose jo, ose eventualisht nëse ka pasur ndonjë pengesë për ekzekutimin e tij.

23. Po kështu, Kolegji konstaton se çështja e themelit të kërkuesit nuk përfshihet në çështjet të cilat mund të shqyrtohen me përparësi referuar vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) nr. 78, datë 30.05.2019 “*Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit*”, që përcakton rregullat e hollësishme për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit. Nga ana tjetër, çështja që lidhet me ndreqjen e gabimit të vendimit, hyn te çështjet për të cilat mund të kërkohet përshpejtim gjykimi, referuar pikës 3.1., shkronja “e”, të vendimit të sipërcituar të KLGJ-së.

24. Kolegji vlerëson të theksojë se në ankimin e tij, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kërkuesi e ka lidhur vetëm me kalimin e afatit ligjor 1-vjeçar të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, për shkak se Gjykata

Administrative e Apelit nuk e ka shqyrtuar ende ankimin e palës së paditur DVP-së, Vlorë, lidhur me themelin e çështjes, si dhe ankimin e tij kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për ndreqjen e gabimit të vendimit. Në këtë kontekst, vlerësohet se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument se si vonesa 1 muaj e 4 ditë pas tejkalimit të afatit 1-vjeçar nga paraqitja e kërkesës së tij për përsheptim në Gjykatë të Lartë dhe 5 muaj e 8 ditë, deri në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, i ka cenuar atij të drejtat kushtetuese.

25. Gjithashtu, edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij (*shih paragrafin 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*) i ka vënë kërkuesit në dukje faktin se nuk i vjen asnjë rrezik nga mosshqyrtimi i çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit.

26. Lidhur me procesin e korigjimit të vendimit, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka dhënë shkaqe që përcaktojnë ose kushtëzojnë ecurinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes kryesore të palëve ndërgjyqëse nga çështja e korigjimit të vendimit për të justifikuar përsheptimin e saj. Gjithashtu, kërkuesi nuk ka paraqitur, bashkëlidhur kërkesës, se ku konsiston korigjimi i kërkuar i vendimit, për rrjedhojë edhe pasojën e ardhur në këtë drejtim për (pa)mundësinë e ekzekutimit të vendimit të tij që i ka njohur të drejtën për të vënë në ekzekutim të përkohshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë nr. 521, datë 19.07.2022.

27. Në këndvështrim të sa më sipër, kërkuesi, pavarësisht se ka barrën e provës në këtë drejtim, nuk ka paraqitur ndonjë argument se si cenimi i së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm i ka sjellë pasojë të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale për t'i dhënë prioritet gjykimin të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit.

28. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.